



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 76 prot.

Tiranë, më 24.01.2024

VENDIM
Nr. 7, datë 24.01.2024

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË
VERIFIKIMIT TË RASTEVE TË NËPUNËSVE QË MBAHEN NË PUNË NË
KUNDËRSHTIM ME LIGJIN PËR NËPUNËSIN CIVIL PAS PLOTËSIMIT TË
MOSHËS SË PENSIONIT TË PLEQËRISË, PËR VITIN 2023**

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme, “Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit të Komisionerit”, miratuar me Vendimin Nr. 18, datë 11.03.2015, Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, i ndryshuar;

Në përfundim të procesit të filluar me Vendimit Nr. 1, datë 04.01.2023 “Për fillimin e mbikëqyrjes mbi situatën e marrëdhënieve të punësimit në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, për verifikimin e rasteve të nëpunësve që mbahen në punë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil pas plotësimit të moshës së pensionit të pleqërisë, për vitin 2023,

VENDOSA:

1. Miratimin e Raportit “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të rasteve të nëpunësve që mbahen në punë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil pas plotësimit të moshës së pensionit të pleqërisë, për vitin 2023”, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse për publikimin e raportit në faqen zyrtare të internetit të Komisionerit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha